



KONTRATE SHITJE (KUOTA)

Ne Tirane sot me date 27/03/2003 para meje noterit Nezir Murati anetari i dhomes se notereve te rrethit Tirane me seli ne bulevardin Bajram Curri" mu paraqiten personalisht dhe me kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shitje kuotash palet:

SHITESI: Aqif Patushi i biri i Sulejmanit dhe i Vashes i datelindjes 1956 lindur ne Burrel dhe banues ne Tirane Rruga "Njazi Meka", madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar e njohur personalisht prej meje.

BLERESI: Petrit Patushi i biri i Sulejmanit dhe i Vashes i datelindjes 1961 lindur ne Burrel dhe banues ne Tirane rruga e Dibres madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar per identitetin e te cilit u sigurova nga leter njoftimi i tij.

Ne baze te Vendimit te Gjykates se Shkalles se Pare te rrethit Tirane me nr.21925 date 08.09.1999 eshte krijuar shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "Areco" shpk me ortake te vetmne Z.Drita Cara.Me vendimin nr. 21925/1 date 27/01/2000 eshte bere shtese objekti ne kete shoqeri.Me vendimin nr 21925/2 date 15/01/2001 eshte bere shitje e kuotave ne masen 100% Z.Aqif Patushi i cili eshte bere ortak i vetem dhe administartor i kesaj shoqerie. Me vendimin nr.21925/3 date 10/05/2001 eshte bere nderrimi i emrit te shoqerise nga "Areco" shpk ne "Agri Konstruksion" shpk,dhe me vendimin nr. 21925/4 date 24/05/2001 eshte bere perseri shtese objekti ne kete shoqeri.

Shitesi : Aqif Patushi deklaroi se me vullnetin e tij te lire dhe te plote i shet bleresit Petrit Patushi 100% te kuotave te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Agri Konstruksion" shpk.

Bleresi: Petrit Patushi deklaroi se eshte dakort me blerjen 100% te kuotave te kesaj shoqerie e barabarte me kapitalin themeltar prej 100.000 leke shume e cila likuidohet jashte kesaj zyre.

Me nenshkrimin e kesaj kontrate shitje kuotash prej te dyja paleve shitesi Aqif Patushi zhvishet teresisht nga pronesia e tij mbi keto kuota dhe pronar i vetem dhe i ligjshem i 100% te kuotave te kesaj shoqerie behet bleresi Petrit Patushi duke mbetur ortak i vetem dhe administrator i kesaj shoqerie.

Kjo kontrate shitje kuotash u redaktua konform ligjit dhe vullnetit te lire dhe te plote te te dyja paleve dhe pasi u lexua nga une noteri dhe u gjend e rregullt nenshkruhet rregullisht pa verejtje prej paleve e une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

SHITESI:

BLERESI:

NOTERI

AQIF PATUSHI
AQIF PATUSHI

PETRIT PATUSHI

NEZIR MURATI